



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0049

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE) “ARITECH” SHPK , kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit të “KK PRISHITNË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA” me numër të prokurimit 616-23-9220-1-1-1, me 16/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “ARITECH” SHPK me nr. 2024/0049, e datës 15/01/2024, kundër vendimit AK-Komuna e Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA” me numër të prokurimit 616-23-9220-1-1-1.
2. Anullohet “Njotimi mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues” i dates, 22.12.2023, për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: 616-23-9220-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna Prishtinë dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.09.2023, “KK PRISHITNË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për

kabinete në IEAA” me nr. të prokurimit: 616-23-9220-1-1-1. Ndërsa me datën 22.12.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “InterAdria” L.L.C

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 296,639.00

Me 27.12.2023, OE “ARITECH” SHPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 05.01.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën si të bazuar.

Me 15.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “ARITECH” SHPK me nr. 2024/0049 për lidhur me aktivitetin “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA” me nr. të prokurimit: 616-23-9220-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” SHPK janë parashtruar si në vijim:

Ne me datë, 22.12.2023 kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Ne njoftimin mbi vendimin AK ka vendosur të shpërblejë me kontratë OE “Interadria” LLC. Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e dorëzuara për dy OE pjesëmarrës me të lirë sipas çmimit të ofruar. AK ka vendosur që të shpërblejë me kontratë kompaninë “Interadria” LLC. Në bazë të kësaj kemi kërkuar qasje në ofertat të dorëzuara për dy operatoret ekonomik.

Me poshtë do të rendisim disa të gjetura të cilat theksojnë mos përmbushjen e kërkesave teknike/administrative nga OE i cili mendohet të shpërblehet me kontratë: Ne me datë 27.12.2023 kemi dërguar kërkesë për Rishqyrtim të AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Ne kërkesën për Rishqyrtim ne kemi parashtruar disa shkelje nga ana e AK-se. Subjekt i kërkesës për rishqyrtim ka qene: 1. Mospërputhja e OE “Interadria” në specifikimit teknik në baze të kërkesës në DT për pjesën e procesorit. 2. Mospërputhja e OE “Interadria” në specifikimit teknik në baze të kërkesës në DT për pjesën e kartelës grafike. 3. Mosplotësimi sipas kërkesës të DT për inxhinier në fushën e IT-së. 4. Mosrespektimi i sqarimeve të dërguara nga ne pas kërkesës për informacion shtese nga vet AK. Përveç asaj që na ka eliminuar, AK nuk është marrë fare me shkeljet që kemi paraqitur në. Është detyrë e Autoritetit kontraktues që në përputhje me LPP të marrë masa për çdo paraqitje të shkeljeve, pavarësisht a vije prej AK-se apo OE-ve. Refuzimi në një mënyrë të tillë, tregon që AK nuk është e interesuar të zbatojë ligjin për të gjithë OE-të në mënyrë transparente dhe të barabartë.

Me këtë rast AK nuk ka dëshmuar që është e barabartë siç kërkohet nga Neni 7 pika 2 i LPP-së, për të gjithë Operatoret ekonomik. 5/11 Ne kemi paraqitur dëshmi të mjaftueshme rreth gjeneratës së fundit të procesorëve, si dhe dëshmi administrative të cilat nuk janë përmbushur nga OE i cili mendohet të shpërblehet me kontratë. Ne vijim mund të shihet kërkesat e specifikimit teknik të paraqitura nga AK: Për pozicionin 2 dhe 3 nga AK në dosje të tenderit janë kërkuar kompjuter të avancuar, PC me procesor të gjeneratës së fundit. Pra kjo kërkesë nuk ka dy kuptimesi, është e qartë: i7 respektivisht i9 të gjeneratës së fundit, përderisa për pozicionin është kërkuar qarte i7 gjenerata e parafundit në datën e publikimit të njoftimit. Specifikimi teknik (kërkesa) për të tri pozicionet është si në vijim: për këto modele të CPU-ve është lansuar gjenerata e fundit (gjenerata e 14th) një muaj para dorëzimit të ofertave.

Për me tepër gjenerata e 14 është implementuar ne të njëjtën kohë edhe nga prodhuesit e PC-ve , si dëshmi gjeni me poshtë oferta te ndryshme ne tregjet evropiane dhe vendore te modelit te njëjtë të ofertuar nga OE fitues ku janë me gjenerate 14th. Dëshmi 1: PC është i disponueshem tek një kompani ne gjermani (gen 14th e CPU)Ne ofertën e dorëzuar nga OE “Interadria” LLC i cili mendohet te shpërblehet me kontrate kemi hasur një kontrate pune dhe CV qe nuk e plotëson kërkesën e AK-se dhe bien ndesh me njëra – tjetrën.Kontrata eshët lidhur me date 06.11.2023 me afat deri me 31.03.2024 ne mes te OE “Interadria” LLC dhe Shpresa Dragusha, përderisa ne CV shkruan qe personi ne fjale punon nga Prilli 2019.Pra kemi të bëjmë me deklarim te rremë apo kontradiktor!Për me tepër përvoja e punës prej 5 vite nënkupton pune ne profesionin e kërkuar, është e pakuptimtë nëse do llogaritet si vit përvojë ne fusha tjera (psh. Shofer, Sektorist ne Market, Shitje, Financa)Sidoqoftë nuk plotësohet kriteri 5 vite përvojë pune siç kërkohet ne dosje te tenderit.

AK ka pas argumente te mjaftueshme për Rishqyrtuar vendimin e tij. Lidhur me ofertën e “Aritech shpk konsiderojmë qe ne pas kërkesës për sqarimeve nga AK kemi sqaruar/dorëzuar specifikimin i cili është ne plotni simbas kërkesës e DT.Ne kemi dorëzuar oferte për pozicionin 2 dhe 3, te gjeneratës se fundit, ashtu siç është kërkuar ne specifikim teknik.Sqarimi ose përgjigja nga ana e Aritech shpk është dërguar për modelin e njëjtë, qe është dorëzuar ne ditën e dorëzimit të ofertave për të dy pozicionet përveç se është sqaruar për pikat që kishte paqartësi nga AK.Prandaj ne nuk e kemi ndryshua pozicionin për produkt duke konfirmuar modelin e njëjtë për pozicionin 2 dhe pozicionin 3, pra oferta jone është për modelin Lenovo Legion T7 versioni i fundit i këtij modeli (gen 14th) Vlerësojmë qe oferta jone është e përgjegjshme, ne përputhje me kërkesat e specifikimit teknik dhe si e tille plotëson 100% kërkesën.Ne besojmë që është detyre e Autoritetit Kontraktues qe te kujdeset te zbatoj ligjin, te jete transparent dhe i barabarte me te gjithë operatoret ekonomik. Arsyetimi i refuzimit të kërkesës për Rishqyrtim tregon qe AK nuk i intereson te jete i drejt dhe i barabarte, prandaj ne paraqesim argumentet tona edhe para Organit shqyrtues te prokurimit.Qasja e AK-se lidhur me refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim me arsyetimin- Pale e interesuar, mendojmë qe është skandaloze. “Aritech” shpk është palë e interesuar ne këtë projekt, sepse kërkon qe lënda te kthehet ne Rivlerësim, te zbatohet Neni 6 pika 1, Neni 7 pika 2, te zbatohet ligji i prokurimit për të gjithë OE-te.

Çuditërisht AK ne pamundësi ti kundërshtoj argumentet e qarta te prezantuara nga “Aritech” Shpk për 3 parashtresat e para, refuzon kërkesën për Rishqyrtim duke hedhur poshtë vetëm parashtresën nr.4 dhe duke lënë te nënkuptueshme qe edhe nëse bën shkelje (tolerim te mosplotësimit te specifikimeve) ne raport me OE-te e tjera , neve si OE nuk ka se çka na intereson pasiqe “ nuk jemi pale e interesit” !!! Vlerësojmë qe AK do duhej vlerësuar argumentet, te cilat kërkojnë apo ia pamundësojnë AK-se qe te mos shkele Nenin 6 pika 1 dhe Nenin 7 pika 2, përkatësisht LPP.”Duke u referuar pretendimeve si më sipër “ARITECH” SHPK konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, Neni 6 , Neni 7. Duke propozuar APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE “ARITECH SHPK” lidhur me tenderin “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA)” me nr. prokurimi616-23-9220-1-1-1ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-se, nga “KK Prishtinë”, të kërkohet qe tenderi të Rikthehet ne Rivlerësim.

-Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:

Lidhur me pretendimet e parashtruesit me rastin e administrimit të dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi dhe krahasimit të tyre me sqarimet shitesë të dërguara më vonë te autoriteti kontraktues është gjetur se specifikat e pajisjes në broshurë sikurse janë nënvizuar nga parashtruesi dallojnë me specifikat e pajisjes në broshurë të nënvizuara me rastin e sqarimeve shitesë. Më konkretisht, parashtruesi gjatë fazës së tenderimit ka dorëzuar broshurat për poz.2 dhe 3 "Lenovo Legion T7 341AZ71 dhe ka nënvizuar modelin e procesorit iCore i712700KF respektivisht Core i912900KFlt ndërsa pas kërkesës për sqarime parashtruesi ka dërguar broshurat për modelin e PC për poz. 2 dhe 3 "Legion T7 341RZ8" dhe ka nënvizuar modelet e procesorëve "Core i714700KF respektivisht Core i914900Kl gjë që bie ndesh me LPP, pasi që OE nuk ka drejtë të ndryshoj produktet pas hapjes së ofertave dhe vlerësimit të tyre. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor i parashtruesit është pretendim i pabazuar.

Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore të parashtruesit të cilat i referohen ekskluzivisht tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit, është gjetur se parashtruesi duke qenë tenderues i papërgjegjshëm në këtë rast nuk mund të dëshmojë asnjë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht nuk është fare palë e interesuar në raport me këto pretendime të tij. Përmes nenit 4 paragrafit 1 në paragrafit 26 të LPP me termin palë e interesuar nënkuptohet "personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili kanë qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Në rastin konkret parashtruesi është tenderues i papërgjegjshëm sikurse është sqaruar edhe në sipër në këtë vendim. Prandaj nga cilindo epilog i mundshëm i këtij aktiviteti të prokurimit, parashtruesi në asnjë formë nuk mund të dëshmojë ndonjë interes material. Prandaj parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me këto pretendime të tij dhe rrjedhimisht pretendimet e tij referuar kundër tenderuesve të tjerë janë të pabazuara.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0049/24, ndërsa me datë 29.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0049 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi i AK dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

-Vlerësimi i pretendimit ankimor OE "ARITECH" SHPK- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0049 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1: "Sipas ankesës 49/24 ka të bëjë me arsyen e parë të eliminimit, ku sipas AK-së OE ankues ka ofruar katalogun me specifikacion teknik i cili nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu sipas AK-së në sqarime shtesë OE ankues nënvizon një produkt tjetër nga ai i ofruar fillimisht, dhe e eliminon OE për shkak të ndryshimit material të ofertës. OE pretendon se ka ofruar sqarime për produktin/modelin e njëjtë dhe nuk ka ndryshime materiale. Pas analizimit të ofertës së OE kemi gjetur se për pozicionin 2 në ofertë ka ofruar katalogun për modelin "Lenovo Legion T7 34IAZ7", ndërsa në sqarime shtesë e ofron modelin "Legion T7 34IRZ8". Në rastin konkret, vlerësimi i ekspertit është se kemi të bëjmë me ndryshim material të ofertës, pasi tjetër model ofrohet në ofertë, dhe tjetër model ofrohet me sqarime të dhëna nga OE. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pa bazuar.

Pretendimi nr.2: "Pretendimi tjera ankimore (të shumta) sipas ankesës 49/24 janë bërë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë (me çmim më të lart se OE ankues). Pas analizimit të vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim (i bashkangjitur me këtë raport), kemi gjetur se AK nuk i është përgjigjur pretendimeve ankimore për mos plotësim të specifikave teknike nga OE i rekomanduar për kontratë. AK këtë veprim e arsyeton se OE ankues është palë pa interes pasi nuk mund të jetë fitues në asnjë rrethanë pa dhënë përgjigje për specifikat teknike të OE të rekomanduar. Në rastin konkret, vlerësojmë se arsyetimi i AK-së është i pabazuar, kjo për arsye se nga dy operator ekonomik (eventualisht

të papërgjegjshëm) po favorizohet OE me çmim më të shtrenjtë për të njëjtat arsye që është eliminuar OE ankues me çmim më të ulët. Me këtë logjike, të gjithë OE-të që dalin me çmim me të ulët janë të rrezikuar që me një ankese nga një OE i cili është me çmim me të lartë, të ju mohohet e drejta e ankesës në emër të Pale pa interes.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimorë janë pjesërisht të bazuara dhe i rekomandojmë panelit të detyroj AK-në që në rast të rivlerësimit të përgjigjet në pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues “ARITECH” SHPK, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” SHPK, i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues, sipas të cilit ka rekomanduar Panelin shqyrtues që lënda të kthehet në Rivlersim.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA” me nr. të prokurimit: 616-23-9220-1-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” SHPK dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në

këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "ARITECH" SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkruesat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit: 616-23-9220-1-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim, AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim dhe Autoriteti kontraktues, obligohet të veproj për evitimin e gjitha shkeljeve ligjore, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE "ARITECH" SH.P.K., të vlerësuara si të bazuara/qëndrueshme sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: "Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - ARITECH**
- Arkivës së OSHP-së: